

MIRATOHET
DREJTORIA E RAJONIT QËNDËR LINDJE KORÇË
DREJTORI
ARDIT MELE

RELACION TEKNIK
(PROJEKT ME PERSHKRIM)

Mirëmbajtje me performancë : Unazë-Ersekë (2.1) + Ersekë-Leskovik (42.8) + Rr.Leskovik - Tre Urat(Doganë) (13.7). (Kontrata Nr 4) L= 58.7 km

Segmentet që mbulon kontrata

Nr.rrugës	Emërtimi i rrugës	Koordinatat e fillimit	Koordinatat e mbarimit	Gjatësia (km)	Gjerësia (ml)
75	Ersekë-Leskovik	N 40°19'55.4" E 20°40'44.6"	N 40°09'11.9" E 20°36'04.9"	42.8	6
W65	Unazë-Ersekë	N 40°20'35.7" E 20°41'16.0"	N 40°19'55.4" E 20°40'44.6"	2.2	8
W59	Rr.Leskovik-Tre Urat(Doganë)	N 40°04'31.6" E 20°35'57.7"	N 40°09'11.9" E 20°36'104.9"	13.7	7
SHUMA TOTALE E KONTRATËS Nr 4				58.7	

1. Përshkrimi i zonës ku ndodhet rruga

Aksi rrugor Unaza Erseke l = 2.2 km

Kjo rrugë është një segment që shërben si Unaza e qytetit të Ersekës. Rëndësia e këtij aksi është e madhe pasi si unaza përcjell lidhjen e qyteteve Korçës, Ersekës, Leskovikut, Permetit dhe Gjirokastrës, shërben për trafikun e mjeteve të rënda.

Është rrugë me një karrexhatë me dy kahe lëvizje.

Shtresat asfaltike janë në gjendje të mirë dhe duhet bërë nderhyrje të vazhdueshme në shtresat që paraqesin demtime..

Kanalet dhe kunetat kanë nevojë për pastrime të vazhdueshme sidomos në periudhën e shirave sjellin aluvione dhe mund të bllokohen funksionimin e kanaleve. ,prezence të shumta të ujërave në rrugë

Bimesia ka nevojë për prerje, pastrime, të vazhdueshme nga pjesët përberëse të rrugës ,sidomos në periudhën pranverë dhe vjeshtë.

Tombinot janë në gjendje të mirë por kanë nevojë të herëpërhershme për pastrime.

E vecante është mirëmbajtja e trotuarëve dhe e ndricimit rrugor.

Bankinat janë kuneta betoni me shtrirje paralele në të dyja anët e rrugës.

Gjendja e sinjalistikës është e mirë por ka nevojë për zvendesimin e tabelave dhe përvijuesve anësorë që demtohen nga banoret e zonës.

Sinjalistika horizontale ka nevojë për rifreskim të plote të vijezimit horizontal.

Rruga është trajtuar me parrake metalike mbrojtëse ,në të cilat duhen kryer punime mirëmbajtje dhe zvendesimi, si dhe kompletimi me sinjale dukshmerie .

Probleme përmbajtje nuk ka , me përjashtime të vogla tek rrugët lidhëse nga të cilat kemi futje papastërtish në periudhat me reshje të forta shiu.

Problem me reshkitje nuk ka.

Rruga kalon ne nje terren kodrinor me mirembajtje dimërore
Niveli i kërkuar i shërbimit te mirembajtjes eshte “i mirë”.



Aksi rrugor : Erseke – Leskovik l = 42.8 km

Ky aks rrugor lidh qytetin e Korces me ate te Ersekës, Leskovikut, për të vazhduar me tej Permet, Tepelene dhe Gjirokastrë.

Eshte aks me rendesi per zonen e juglindjes.

Është aks rrugor me një karrexhatë me dy kahe lëvizje.

Ky aks rrugor ne gjithe gjatesine e tij i eshte nenshtruar nje rikonstruksioni nga ana F.SH.ZH eshte gati drejt perfundimit.

Gjersia e asfaltit te ruges se re , b= 5 m. Gjersia e rruges B= 6.0 m- 7.0 m.

Me shtresa te reja asfaltike.

Ne zona te vecanta me bordura dhe kuneta betoni.

Nisur na natyra e relievit ku kalon dhe gjatesia e tij ka nevoje per mirembajtje te vazhdueshme ne te gjitha elementet perberes te rruges.

Kanalet dhe kunetat kane nevoje per pastrime te vazhdueshme sidomos ne periudhen e shirave pasi shpatet anesore sjellin aluvione.


Tombinot dher urat box edhe pse te reja dhe ne gjendje te mire , kane nevoje te herepashershme per monitorim dhe per pastrime ..

Sinjalistika dhe siguria rrugore do te kenë nevojë për rifreskime dhe zëvendësime të pjeseshme dhe te vazhdueshme , per zvendesimin e tabelave dhe pervijuesve anesore, qe amortizohen dhe demtohen gjate periudhes dimerore.

Sidomos ne kompletimin me guardrails te rinj ne vendet ne nevoje.

Rruga është në terren kodrinor dhe malor me mirëmbajtje dimërore.

Niveli i kërkuar i shërbimit tre mirembajtjes “i mirë”.





Aksi rrugor : Leskovik – Tre Urat (dogana)

Ky lidh qytetin e Ersekës, Leskovikut, Permetit dhe Gjirokastrës.

Ne të ndodhet edhe pika doganore e Tre Urave që lidh Shqipërinë me Greqinë.

Është aks rrugor i ndërtuar i ri në vitet e fundit, me një karrexhatë me dy kahe lëvizje.

Gjersia e asfaltit 6 m + kune të betonit + bordurë.

Shtresat asfaltike janë në gjendje të mirë me nevojë për riparime dhe nderhyrje riparuese në pjesë të caktuara, me amortizim të shtresës konsumuese,

Përgjatë këtij segment janë evidentuar disa vende me demtime të karexhatave me ulje dhe deformime të cilat kërkojnë një nderhyrje me specifike me paketa asfaltike çakull + binder + asfaltobeton.

Kuneta anësore dhe tombinat kanë nevojë për pastrim të vazhdueshme

Kanalet, kune të betonit, karexhata nga km 4+000 - km 12+000 kanë nevojë për pastrime të vazhdueshme, sidomos në periudhën e shirave pasi shpëtohet anësorja e shpellave aluvionale.

Rruga ka nevojë për trajtim të skarpave anësore për minimizimin e shkarjes së matrejtës nga skarpata në rrugë.

Gjendja e sinjalistikës është e mirë por ka nevojë për zvendosimin e tabelave dhe përvijuesve anësorë, që amortizohen dhe demtohen edhe gjatë periudhës dimërore.

Vijezimi i rrugës është relativisht i mirë por ka nevojë për rifreskim të tij.

Rruga ka nevojë për vendosje murre pritëse dhe guardrails.

Sinjalistika dhe siguria rrugore kanë nevojë për rifreskim dhe zëvendësime të pjesëshme dhe të vazhdueshme.

Rruga është në terren kodrinor me një karrexhatë me Mirëmbajtje Dimërore.

Niveli i kërkuar i shërbimit të mirëmbajtjes “i mirë”.



